otpbank



RAPORTIME PERIODIKE

30-Jun-26

PËRMBAJTJA

01_	Informacion i përgjithshëm për bankën
02_	Të përgjithshme
03_	Bilanci Kontabël (Aktiv - Pasivet) dhe Zërat jashtë Bilancit
04_	Pasqyra e Llogarisë "Të ardhura dhe shpenzime" dhe Treguesit e Rentabilitetit
05_	Struktura e Kapitalit Rregullator
06_	Mjaftueshmëria e Kapitalit
07_	Mjaftueshmëria e Kapitalit për Rrezikun e Kredisë, Rrezikun e Tregut dhe Rrezikun Operacional
08_	Rreziku i kredisë dhe Rreziku Operacional
09_	Klasifikimet e portofolit të Kredisë sipas degëve të Ekonomisë dhe shperndarjes gjeografike
10_	Klasifikimet e portofolit të Kredisë sipas degëve të Ekonomisë dhe shpërndarjes gjeografike (Vazhdim)
10.1_	Klasifikimet e portofolit të Kredisë sipas maturitetit të mbetur.
11_	Kreditë sipas kalimit të afatit të kthimit. Fondet Rezervë për humbjet nga kreditë
12_	Rreziku i Normës së Interesit në Librin e Bankës
13_	Rreziku i Likuiditetit
14_	Depozita ekuivalente e kapitalit dhe Matja dhe kontrolli i kufijve të rrezikut

01

INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI BANKËN

01. Emri i Subjektit:	*Banka OTP Albania*
02. Forma ligjore:	*Shoqëri Aksionare*
03. Zyra qëndrore e shoqërisë në Shqipëri:	*Tirane, Bulevardi Deshmoret e Kombit, Twin Towers, Kulla 1, kati 9*
04. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS):	*K41424801U*
05. Data e Regjistrimit:	*24/02/2004*
06. Data e themelimit:	*12/11/2003*
07. Kapitali:	*6.740.900.000,00*
08. Vlera e kapitalit të shlyer:	*6.740.900.000,00*
09. Numri i aksioneve:	*67.409,00*
09.1 Vlera nominale:	*100.000,00*
10. Aksionarët:	*OTP Bank Nyrt*
11. Forma juridike:	*Shoqëri Aksionare*
12. Adresa:	*1051 Budapest, Nádor utca 16*
13.1 Numri i Aksioneve:	*Me të drejtë vote : 67.409,00* *Pa të drejtë vote : 0*
13.2 Përqindja e pjesëmarrjes:	*100.00*
14. Objekti i aktivitetit:	

a. *Pranimi i depozitave monetare ose i fondeve te tjera te ripagueshme nga publiku dhe perdorimi i tyre per dhenie kredie e vendosje ne emer dhe per llogari te vet*

b. *Dhenie huash te te gjitha llojeve*

c. *Faktoring dhe financim te transaksioneve tregtare*

d. *Qira financiare;*

e. *Te gjitha sherbimet e pagesave dhe te transferimit te parave.*

f. *Ofrim garancish dhe marrje angazhimesh*

g. *Tregtimin per llogari te vetën ose per llogari te klienteve*

i. instrumente te tregut te parase
ii. kembim valutor.
iii. produkte derivate
iv. instrumente te kembimeve valutore dhe unstrumente per vlersimin e normes se interesit
v. letra me vlere te transferueshme;
vi. instrumente te tjera te negociueshme dhe aktive financiare

h. *Ndermjetesim për transaksionet monetare te meposhtme*

i.administrimin e aktiveve te tilla, si administrimi i parave dhe i portofolit, administrimi i fondeve, marrja ne kujdestari, sherbimet depozituese dhe te besimit;
ii. sherbimin per kompensimin dhe shlyerjen e pagesave te aktiveve financiare,
iii. sigurimin dhe transferimin e informacionit financiar

i. *Sherbime keshilluese, ndermjetesimi dhe sherbime te tjera ndihmese per te gjitha aktivitetet e percaktuara ne pikat (a)-(h) me siper*

j. *Emetimin dhe administrimin e instrumenteve te pageses*


k.*Te ushtroje veprimtarine e ndermjetesimit ne sigurime dhe risigurime*

I.*si edhe cdo aktivitet tjeter qe mund te konsiderohet i nevojshem apo i domosdoshem per aktivitetin e Bankes si edhe cdo aktivitet tjeter financiar qe percaktohet nga licencat e Bankes leshuar nga autoritetet kompetente.*

15. Administratori/ët

Bledar Shella

Struktura Organizative me 30 Qershor 2026



Banka OTP Albania operon në të gjithë Shqipërinë nëpërmjet rrjetit të saj me 50 degë me një numër total të stafit prej 809

Këshilli Drejtues është organ mbikëqyrës dhe vendimmarrës. Ai është i përbërë nga një numër prej 7 (shtatë) anëtarësh që janë emëruar me një mandat 4-vjeçar nga Asambleja e Aksionarit të vetëm, të cilët zotërojnë njohuri dhe përvojë në fusha të ndryshme, aftësi manaxhuese të konfirmuara dhe vendimmarrje të orientuar drejt riskut dhe tolerancës ndaj riskut, duke u siguruar kështu që vendimet e saj të jenë objekt i një analize të detajshme. Këshilli Drejtues i Bankës OTP Albania ka një shumicë anëtarësh të pavarur të cilët sigurohen në çdo kohë që të mos jenë të përfshirë në një situatë konflikti interesi me Bankën dhe aksionarin e saj.

Anëtarët e Këshillit Drejtues
(plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele)

Gabor Kolics (Kryetar)
Orsolya Csilla Kovács (Nën Kryetar)
Armand Duka (Anëtar)
Ilir Ciko (Anëtar)
Janos Veres (Anëtar)
Örs Levente Szilágyi (Anëtar)
Stavri Pashko (Anëtar)



Z. Gabor Kolics - Kryetar i Këshillit Drejtues

Mandati Aktual - 28.12.2022 - 28.12.2026

Z.Gabor Kolics, shtetas Hungarez, është i diplomuar nga Universiteti i Shkencave Ekonomike për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Ekonomiks. Z. Kolics punon në industrinë bankare që prej vitit 2004, vit në të cilin është bashkuar me Grupin OTP si Analist i Riskut.
Për një periudhë të shkurtër, ai u promovua si Menaxher i Lartë i Departamentit të Blerjes dhe Koordinimit të Bankave. Prej vitit 2019, Z. Gabor Kolics është drejtor menaxhues i Drejtorisë së Blerjeve dhe Integrimit të Grupit, përgjegjës për ekzekutimin e projekteve të Merger & Acquisition dhe integrimit të OTP Group, si dhe funksionin e kontrollit, raportimit dhe planifikimit në Divizionin e Bankave Tregtare.

Ndërmjet Dhjetorit të vitit 2017 dhe 2021, z. Kolics ka qenë kryetar i Bordit të Drejtorëve të Vojvodanska Banka gjatë bashkimit të saj me OTP banka Srbija, më pas me Societe Generale Srbija. Që nga maji i vitit 2021 z. Kolics është anëtar i bordit të drejtorëve të OTP banka Srbija dhe prej 2011, Z. Kolics është Kryetar i Bordit Mbikëqyrës të Fondit të Kapitalit Sipërmarrës të Portofolit.
Z. Kolics ka patur disa anëtarësime të tjera në filialet e Grupit OTP, duke përfshirë atë të CKB Bank (Mali i Zi) dhe DSK Bank (Bullgari).

Z. Kolics është kryetar i Këshillit Drejtues i Bankës OTP Albania që nga viti 2022.



Znj.Orsolya Csilla Kovács- Nën Kryetare e Këshillit Drejtues

Mandati Aktual - 19.04.2023 – 19.04.2027

Znj. Orsolya Kovacs, shtetase Hungareze, është diplomuar në Universitetin Corvinus të Budapestit në profilin Menaxhim dhe Organizim. Znj. Kovacs punon në industrinë bankare që nga viti 2006, vit në të cilin është bashkuar me OTP Group si analiste financiare. Që nga viti 2022, znj. Orsolya Kovacs është Drejtoreshë e Departamentit të Analizës Strategjike përgjegjëse për mbështetjen e vendimmarrjes strategjike në OTP Group.

Prej vitit 2022, znj. Kovacs është anëtare e Bordit Mbikëqyrës të OTP Home, një filial i OTP Group për ofrimin e ekosistemit të pasurive të paluajtshme në internet të OTP Group.

Znj. Kovacs është nënkryetare e Këshillit Drejtues të OTP Albania që nga viti 2023.



Z. Armand Duka - Anëtar i Këshillit Drejtues

Mandati Aktual - 15.10.2023 - 15.10.2027

Z.Armand Duka, shtetas shqiptar, është diplomuar në Universitetin e Tiranës (Shqipëri), Dega e Ekonomisë për Industri në vitin 1986. Z. Duka ka filluar karrierën në profesionin e ekonomistit në Parkun e Mallrave në Burrel në vitet 1986-1990. Gjatë viteve 1990-1991, Z. Duka ka ushtruar profesionin e tij si ekonomist në Parkun e Mallrave të Eksportit në Durrës. Duke filluar nga viti 1993, Z. Armand Duka është sipërmarrës në sektorë të tjerë privatë, zotërues dhe aksionar në disa biznese të mirënjohura, ku rikonfirmon kështu aftësitë e tij shumë të mira manaxhuese dhe drejtuese.

Z. Armand Duka është zgjedhur president i Federatës Shqiptare të Futbollit në vitin 2002, post të cilin e mban edhe aktualisht, duke u rizgjedhur në vitet 2006-2010-2014-2018. Gjatë këtyre viteve në krye të Federatës Shqiptare të Futbollit ka mbajtur dhe këto detyra: Anëtar i Komitetit të Fededartave në UEFA (2008-2012); Zv/Kryetar i Komitetit të Federatave Kombëtare në UEFA (2006-2008); Zv/Kryetar i Komitetit të Kompeticioneve të Ekipeve Kombëtare (2008-2013); Zv/Kryetar i Komitetit të Federatave Kombëtare (2013-2016); Zv/ Kryetar i Komitetit HatTrick (2016-sot); Anëtar i Komitetit të Federatave në FIFA (2008-2012) dhe Anëtar i Komitetit Organizator të Kupës së Konfederatave (2012-2017).

Ndër vite, Z. Armand Duka është nderuar me disa tituj, ku mund të përmendim: titullin "Qytetar Nderi" (1998) akorduar nga Bashkia e Shijakut dhe titujt "Nderi i Qytetit" (2001), "Simbol i Qytetit të Durrësit"(2002) dhe "Dyrrah – 3000" (2003), akorduar nga Bashkia e Qytetit të Durrësit dhe Shoqata "Durrësi". Në vitin 2010, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Z.Bamir Topi e dekoron me titullin e lartë "Naim Frashëri" të Klasit të Parë, për kontribut të shquar, në drejtimin dhe zhvillimin e futbollit shqiptar. Në vitin 2019, Z. Duka akordohet me titullin "Konsull nderi i Hungarisë" për Republikën e Shqipërisë.

Z. Duka është anëtar i Këshillit Drejtues i Bankës OTP Albania që nga viti 2019.



Z. Ilir Ciko - Anëtar i Këshillit Drejtues

Mandati Aktual - 01.11.2024 - 01.11.2028

Z. Ilir Ciko është një ekonomist shqiptar i cili ka një master në Administrim Publik nga Universiteti i Harvardit dhe një MBA nga Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës dhe Universiteti i Nebraskës. Z. Ciko ka përvojë të konsiderueshme dhe angazhim afatgjatë në menaxhimin e institucioneve dhe ekipeve private e publike, si dhe në zhvillimin dhe zbatimin e projekteve të mëdha dhe buxheteve. Përvoja e tij 27-vjeçare përfshin kërkime dhe konsulenca të ndryshme zhvillimi për organizata ndërkombëtare, kontribut si ekspert në administratën publike, duke përfshirë pozicionin e zëvendësministrit të ekonomisë (2003-2005) dhe aktivitet të vazhdueshëm akademik që nga viti 2004 si pedagog në Universitetin e New York në Tiranë dhe aktualisht në Institutin Kanadez të Teknologjisë.

Për shumë vite, Z. Ciko ka shërbyer në bordet e korporatave më të mëdha publike dhe private në Shqipëri. Gjatë periudhës 2012 – 2022 ka shërbyer si anëtar i pavarur i bordit drejtues të ish-Alpha Bank Albania dhe anëtar i komitetit të riskut të bankës. Z. Ciko ka kontribuar në përgatitjen e dokumenteve të dukshme të zhvillimit të qëndrueshëm dhe strategjik për Shqipërinë, duke përfshirë së fundmi Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030 dhe shumë raporte dhe dokumente politikash, që lidhen me rrugën e Shqipërisë në arritjen e Axhendës 2030 SDGs. Ai ka qenë autor i shumë artikujve dhe publikimeve mbi një spektër të gjerë çështjesh ekonomike në Shqipëri dhe rajon, si dhe ka qenë anëtar akademik i FMN-së në Takimet Pranverë të Bankës Botërore dhe FMN-së. Ai është bashkëthemelues dhe president i Klubit të Harvardit të Shqipërisë për periudhën 2014-2020.

Në Qershor 2023 është emeruar si Anëtar i Këshillit Drejtues të Bankës OTP Bank Albania.



Dr. Janos Veres - Anetar i Këshillit Drejtues

Mandati Aktual - 25.03.2023 – 25.03.2027

Dr. Janos Veres, një shtetas hungarez, është diplomuar në Inxhinieri në Fakultetin e Shkencave Bujqësore të Universitetit të Debrecenit (Hungari) dhe ka kryer studimet e doktoraturës për Ekonomi në Universitetin Karl Marx, Budapest (Hungari). Dr. Veres ka një përvojë 32-vjeçare në sektorët publikë dhe privatë. Nga viti 1997 deri në vitin 2002, Dr. Veres ka qenë Kryetar i Dhomës së Tregtisë për rajonin Szabolcs-Szatmár-Bereg.
Ai ka qenë një anëtar i zgjedhur i Asamblesë Kombëtare/Parlamentit të Hungarisë (1994-2014) dhe përgjatë viteve, Dr. Veres ka zhvilluar një karrierë në politikë ku ia vlen të përmenden pozicionet si: Sekretar i Shtetit në Ministrinë e Financave (2003-2004), Sekretari i Shtetit në Zyrën e Kryeministrit (2004-2005) dhe Ministrër i Financave (2005-2009).

Në pozicionin e tij si Ministër, Dr. Veres ka qenë përgjegjës për çështjet rregullatore, mbikëqyrëse dhe monitoruese të sektorit bankar dhe të institucioneve të tjera financiare, për çështjet e taksimit të ekonomisë, për të gjithë fushën e buxhetit dhe manaxhimit të aseteve shtetërore. Ai gjithashtu përgatiti dhe zbatoi një skemë të suksesshme për të manaxhuar ndikimet e krizës financiare të vitit 2008. Dr. Janos Veres është zgjedhur kryebashkiak i vendlindjes së tij, Nyírbátor (2002 - 2003) dhe tani vazhdon të japë kontributin e tij të vyer në Këshillin Bashkiak të Nyirbatorit.
Sa lidhur me karrierën e tij akademike, në vitin 2009, Dr. Veres ka qenë Docent në Universitetin e Debrecen dhe është autor i shumë botimeve në fushën financiare dhe ekonomike për universitetet hungareze dhe të huaja.

Duke filluar nga Mars, 2019 Dr. Veres është anëtar i Këshillit Drejtues të Bankës OTP Albania.



Z.Örs Levente Szilágyi - Anëtar i Këshillit Drejtues

Mandati Aktual - 29.06.2023 – 29.06.2027

Z. Örs Levente Szilágyi, shtetas hungarez, është diplomuar në Universitetin Corvinus të Budapestit me fokus drejtimin e analizës së investimeve dhe menaxhimit të rrezikut (2007). Ai zotëron gjithashtu një diplomë të përbashkët MBA në Administrim Biznesi nga Mastriht School of Management dhe SEED Hungary (2020).

Z. Szilágyi ka punuar në industrinë bankare që nga viti 2007 në fushën e menaxhimit të rrezikut. Karriera e tij ka filluar si zhvillues i modeleve të riskut dhe që prej vitit 2010 ka drejtuar departamente të ndryshme të rrezikut në sektorin bankar hungarez. Z. Szilágyi u bashkua me OTP Group në vitin 2016 si drejtor i Departamentit të Përgjithshëm të Analizës dhe Modelimit, rol të cilin e mban dhe sot. Që nga viti 2023, z. Szilágyi është anëtar i Bordit Mbikëqyrës të OTP Faktoring cPlc. filial i OTP Group.

Z. Szilágyi është anëtar i Këshillit Drejtues të Bankës OTP Albania që nga viti 2023.



Z. Stavri Pashko - Anëtar i Këshillit Drejtues

Mandati Aktual - 23.05.2023 – 23.05.2027

Z. Stavri Pashko, shtetas shqiptar, është i diplomuar në Universitetin e Torinos për Shkenca Strategjike dhe ka një diplomë MBA në Udhëheqje për Qëndrueshmëri. Z. Stavri Pashko ka një përvojë të thelluar në auditimin e brendshëm, menaxhimin e riskut, zhvillimin e biznesit dhe qëndrueshmërinë. Me mbi 17 vjet përvojë në industri, Z. Pashko e ka nisur eksperiencën e tij te ProCredit Bank Albania dhe ish-Societe Generale Albania, duke vijuar më pas në kompani ndërkombëtare si Telia Company, Volvo Group dhe Volvo Cars.

Gjatë gjithë karrierës së tij, Z. Stavri Pashko ka treguar përkushtim ndaj profesionit të audituesit. Ai është një nga themeluesit e Institutit Shqiptar të Audituesve të Brendshëm dhe ka kontribuar prej disa vitesh si anëtar i Komitetit Udhëheqës për Institutin Global të Audituesve të Brendshëm me seli në SHBA. Në vitet e fundit, Stavri ka vepruar si kryetar i Komitetit të Kontrollit dhe Anëtar i Këshillit Drejtues i ish-Alpha Bank Albania. Aktualisht, Stavri është një Zhvillues i Biznesit të Qëndrueshmërisë në Volvo Cars, i fokusuar në sigurimin e pajtueshmërisë me qëndrueshmërinë dhe integrimin e praktikave të qëndrueshmërisë në operacionet e biznesit global.

Z. Pashko është anëtar i Këshillit Drejtues të Bankës OTP Albania që nga viti 2023.

Struktura e Aksionarëve

Subjekti: OTP Bank Nyrt, 1051 Budapest, Nádor utca 16% e pjesëmarrjes në Bankë 100%

Kapitali Social i nënskruar dhe paguar është 28,000,001,000 HUF
Struktura aksionare e OTP Bank Nyrt është e përbërë si më poshtë vijon (aksionarë me mbi 5%)

Aksionari	*% e pronësisë*	*Me të drejtë vote*
MOL (the Hungarian Oil and Gas Company)	*8.57%*	*8.59%*
Kafijat LTD	*7.04%*	*7.05%*
Groupama Group	*5.09%*	*5.10%*

(Përditësimi i fundit: 30 Qershor 2026)

Kodi i Etikës

Kodi i Etikës së Bankës OTP Albania (në vijim referuar si "Banka") formulon udhëzime dhe kërkesa të qarta dhe të pagabueshme si për Bankën, ashtu edhe për degët e saj, në lidhje me operacionet etike të biznesit, me qëllim mbrojtjen e vlerave të Bankës.

Banka miratoi Kodin e Etikës të Grupit në përputhje me ndryshimet dhe kërkesat e jashtme dhe të brendshme, Kod i cili i nënshtrohet ndryshimeve dhe zhvillimeve të vazhdueshme. Kodi i Etikës bazohet në standarde ndërkombëtare, praktikat më të mira dhe përvojat e veta operacionale, të cilat marrin në konsideratë kërkesat e vendosura për Bankën dhe realizimin e tyre praktik. Sistemi i qeverisjes së korporatës të Bankës i shërben njëkohësisht besimit dhe kënaqësisë së klientit, rritjes së vlerës së aksionarëve dhe përgjegjësisë sociale.

Pajtueshmëria me rregullat e etikës dhe funksionimin etik brenda Bankës mbikëqyret nga House Committee, në përputhje me parimet dhe format e pritura të sjelljes të përcaktuara në Kodin e Etikës. Banka ofron mundësinë që këto shkelje të Kodit të Etikës të raportohen qoftë personalisht, përmes telefonit ose me postë elektronike; për më tepër, banka ndërmerr çdo veprim të mundshëm për të mbrojtur punonjësit që raportojnë shkelje nga diskriminimi dhe trajtimi i padrejtë: banka ndalon aplikimin e masave hakmarrëse ose pasojave negative ndaj kujtdo që raporton në mirëbesim çdo shkelje të supozuar ose të vërtetë të vlerave dhe parimeve të Kodit të Etikës.

Banka i kushton një rëndësi të veçantë faktit që punonjësit duhet të njihen mirë dhe të sensibilizohen lidhur me normat e etikës, ndaj dhe për këtë arsye ajo organizon programin e leksioneve elektronike (e-learning) për çdo punonjës, dhe ndërkohë rishikon dhe monitoron rregullisht respektimin e këtyre normave.

Konflikti i interesit

Banka gjatë aktivitetit të saj gjendet ndërmjet interesash të shumfishtë me drejtime të kundërta ose të ndryshme (interesat e klientëve, të vetë kompanisë ose të punonjësve). Të tilla situata gjenerojnë atë që njihet si konflikt interesi. Të veprosh në favor të njërit prej këtyre interesave mund të dëmtoje atë të të tjerevë.

Nëse konflikti i interesit nuk identifikohet apo menaxhohet sic duhet mund të shkaktojë humbje të të ardhurave, dëmtim të reputacionit te Bankës, akte ligjore apo gjobvënie nga autoritetet rregullatore ndaj Bankës apo punonjësve përkatës. Qellimi i Bankës është të kuptojë dhe identifikojë situatat e mundshme qe mund te gjenerojnë konflikt interesi në mënyrë që të parandalojë apo korrigjojë në rast të ndodhjes.

Instruksionet e trajtojnë konfliktin e interesit në dy kategori kryesore në varësi nëse në të jane të përfshirë klientët apo punonjësit:

I.**Konfliket e mundshme të interesit që mund të lindin ndërmjet:**

- ***a)*** *Bankës (ose punonjësve të saj) dhe klientëve*
- ***b)*** *strukturave të ndryshme të Bankës*
- ***c)*** *ndërmjet klientëve*

II. Konfliktet e mundshme të interesit që mund të lindin ndërmjet Bankës dhe punonjësve të saj duke përfshirë këtu interesat private të punonjësve dhe ato të lidhura me detyrimet profesionale.

02

TË PËRGJITHSHME

Të përgjithshme

OTP Bank sh.a. ("Banka") është një institucion financiar shqiptar i krijuar më 12 dhjetor 2003 sipas ligjit shqiptar mbi shoqëritë tregtare dhe u licensua nga Banka e Shqipërisë ("Banka Qendrore") më 16 shkurt 2004 (vendimi nr. 17) që të operojë si bankë në të gjitha fushat e aktivitetit bankar në Shqipëri në përputhje me ligjin Nr.8365 "Mbi sistemin bankar në Shqipëri" i muajit korrik 1998. Banka është gjithashtu subjekt i ligjit No.8269 i dhjetorit 1997, "Mbi Bankën e Shqipërisë".
Banka ka filluar aktivitetin më 1 mars 2004.
Bazuar në marrëveshjen për blerjen e aksioneve e nënshkruar më 29 Mars 2019, OTP Bank "shoqëria mëmë" bleu 100 % të aksioneve të Bankës.

Përmbledhja e politikave bazë kontabël

(a) Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare të përmbledhura janë përgatitur në përputhje me "Metodologjinë e Raportimit Financiar" ("MRF") e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë më 24 dhjetor 2008. MRF u miratua për qëllime rregullatore, në përputhje me Nenit 47 të Ligjit mbi Bankat nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".
Pasqyrat financiare të ndërmjetme të përmbledhura janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Të dhënat aktuale dhe ato krahasuese janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe.

(b) Paraja dhe ekuivalentet me to

Për qëllime raportimi të rrjedhës së parasë, aktive monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë gjendjen e arkës dhe aktivet monetare të depozituara në Bankën e Shqipërisë, si dhe investimet afatshkurtra likuide me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, me përjashtim të rezervës së detyrueshme.

(c) Investimet në letrat me vlerë

Investimet në letrat me vlerë përfshijnë Bono Thesari dhe Obligacione Qeveritare.

Bono thesari:
Bonot e thesarit paraqiten me vlerën e tyre nominale minus interesin e pa maturuar. Kur një bono thesari fiton interes implicit, norma efektive e interesit llogaritet dhe interesi efektiv amortizohet gjatë jetëgjatësisë së letrës me vlerë.

Obligacionet qeveritare:
Obligacionet qeveritare paraqiten me vlerën e kostos pas zbritjes së provigjoneve për humbje të përhershme. Obligacionet qeveritare kontabilizohen me çmimin e blerjes dhe interesin e përllogaritur për kuponat e pagueshëm. Prime apo skonto mbi vlerën nominale në momentin e blerjes përllogariten dhe mbarten deri në datën e pagesës së principalit.

(d) Kredi dhënë klientëve

Kreditë dhënë klientëve paraqiten në vlerën e tyre bruto. Provigjoni për humbje nga kreditëparaqitet si detyrim në bilancin kontabël.

Provigjonet krijohen në zbatim të rregullores së Bankës së Shqipërisë "Për Manaxhimin e Rrezikut të Kredisë" (e ndryshuar), e miratuar me vendimin nr. 62 datë 14.09.2011, ndryshuar me vendimin nr.27, datë 27.03.2013, ndryshuar me vendim nr. 22, datë 27.02.2014, ndryshuar me vendim nr. 26, datë 01.04.2015 dhe ndryshuar me vendim nr. 50, datë 30.03.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë

Rregullorja kërkon që Banka të klasifikojë portofolin e saj të huasë sipas kategorive të mëposhtme, duke zbatuar këto norma për provigjonet e huasë:

Loji i kredisë	*Provigjioni i humbjes*
Standarde	*1%*
Në ndjekje	*5%*
Nënstandarde	*20%*
Të dyshimta	*50%*
Të humbura	*100%*

Kreditë dhe paradhëniet klientëve janë të ekspozuar në shumën e tyre neto pas zbritjes së provigjoneve për humbje nga kreditë e klasifikuara si nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Provigjone të vlerësuar për humbjet e mundshme nga kreditë të klasifikuara si Standard, të vona dhe të veçanta janë paraqitur si provigjone statistikore.

(e) Aktive dhe pajisje të trupëzuara

Aktive dhe pajisje të trupëzuara paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar, i cili llogaritet në bazë lineare mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktiveve. Parashikimi mbi jetëgjatësinë e aktiveve për periudhën aktuale dhe atë paraardhëse paraqitet si më poshtë.

Kategoria	*Jetëgjatësia (Në vite)*
Ndërtesa	*30*
Kompjutera dhe pajisje elektronike	*5*
Instalime dhe pajisje të ndryshme	*5*
Mobilje zyre	*10*
Mjete transporti	*5*

Metodat e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur e aktiveve rishikohen në datën e raportimit. Aktivet në proçes nuk amortizohen.

(f) Aktive të patrupëzuara

Aktivet e patrupëzuara paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar. Parashikimi mbi jetëgjatësinë e aktiveve për periudhën aktuale dhe atë krahasuese paraqitet si më poshtë:

Kategoria	*Jetëgjatësia (Në vite)*
Programe kompjuterike- Sistemi Bankar	*10*
Programe kompjuterike të tjera	*5*

(g) Përmirësim/përshtatje e ambjenteve të marra me qira

Përmirësimi i ambjenteve të marra me qira paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar. Amortizimi llogaritet me metodën lineare për periudhën e zgjatjes së qirasë. Vlera neto e përmirësimeve të ambienteve të marra me qira përfshihet në aktivet e tjera.

(h) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen në bazë të parimit të të drejtave të konstatuara, me përjashtim të interesave të fituara nga kreditë me probleme, të cilat njihen në momentin e arkëtimit.

Të ardhurat nga komisionet lidhen me shërbimet financiare që u ofrohen klientëve, duke përfshirë shërbimet e administrimit të aktiveve monetare, shërbimet komisionere dhe konsulencën financiare. Këto të ardhura njihen në momentin e kryerjes së shërbimit.

(i) Tatimi

Banka përcakton tatimin në fund të periudhës ushtrimore në përputhje me legjislacionin shqiptar për tatim-taksat, si 15% e të ardhurave të tatueshme. Të ardhurat e tatueshme llogariten duke korrigjuar fitimin para tatimit me disa zëra të ardhurash dhe shpenzimesh, sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar.

(j) Transaksionet në monedha të huaja

Transaksionet në monedha të huaja këmbehen me kursin e këmbimit që është në fuqi në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja, të pasqyruara me koston historike të tyre, këmbehen me kursin e këmbimit në datën e mbylljes së bilancit.

Diferencat e rezultuara nga këmbimi reflektohen në pasqyrën e përmbledhur të ardhurave dhe shpenzimeve. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedha të huaja, të pasqyruara me kosto historike, këmbehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Gjithashtu, provigjonet për humbjet nga kreditë në monedha të huaja këmbehen me kursin e këmbimit në datën e raportimit.

03

BILANCI KONTABËL (AKTIV - PASIVET) DHE ZËRAT JASHTË BILANCIT

Përmbledhja e politikave bazë kontabël (vazhdim)

(i)Tatimi

Banka përcakton tatimin në fund të periudhës ushtrimore në përputhje me legjislacionin shqiptar për tatim-taksat, si 15% e të ardhurave të tatueshme.

Të ardhurat e tatueshme llogariten duke korrigjuar fitimin para tatimit me disa zëra të ardhurash dhe shpenzimesh, sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar.

(j)Transaksionet në monedha të huaja

Transaksionet në monedha të huaja këmbehen me kursin e këmbimit që është në fuqi në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja, të pasqyruara me koston historike të tyre, këmbehen me kursin e këmbimit në datën e mbylljes së bilancit. Diferencat e rezultuara nga këmbimi reflektohen në pasqyrën e përmbledhur të ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedha të huaja, të pasqyruara me kosto historike, këmbehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Gjithashtu, provigjonet për humbjet nga kreditë në monedha të huaja këmbehen me kursin e këmbimit në datën e raportimit.

Bilanci Kontabël (Aktiv - Pasivet) dhe Zërat jashtë Bilancit

Fundi i muajit Qershor 2026 rezultoi i suksesshëm për OTP Bank sh.a., duke vijuar me ecuritë pozitive dhe realizuar më së shumti pritshmëritë e saj në treguesit kryesore, si në "Bilanc" ashtu edhe në Pasqyrën "Të Ardhura dhe Shpenzime".

Kështu, portofoli i kredive pati rritje 7.8 miliard lekë në fund të muajit Qershor të vitit 2026 ose me 6.17% krahasuar me fundvitin 2025, ndërkohë që kreditë me probleme kanë qenë stabël në nivele minimale. Raporti i Kredive të Këqija mbi Totalin e Kredive në fund të muajit Qershor është 3.12% duke pësuar një rënie prej 0.24% krahasuar me vitin 2025.

Gjatë vitit 2026 portofoli i vendosjeve dhe kredive me bankat pati një rënie prej 1.4 miliard krahasuar me fundvitin 2025 ose rënie prej 52.82%.

Gjatë vitit 2026, portofoli i depozitave pati një rritje prej 5.6 miliard LEK ose 3.54% krahasuar me fundvitin 2025 duke përfshirë këtu rritje me 6.5 miliard LEK te llogaritë rrjedhëse si dhe llogaritë rrjedhëse të institucioneve publike dhe interesat e përllogaritur dhe rritje me 811 milion LEK të depozitave pa afat si dhe nje rënje me 1.738 miliard LEK të depozitave me afat dhe interesat e përllogaritur për secilën kategori.

Treguesi i likuiditetit qëndron në nivele të larta (28.77%) dhe gjithashtu treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit qëndron në nivelin 18.66% duke qëndruar në nivele stabël në mbyllje të vitit të 2025.

Në fund të muajit Qershor 2026, Banka realizoi një fitim prej rreth 1.862 miliard LEK, duke qenë në linjë me parashikimet e saj buxhetore. Kjo u arrit falë rritjes të të ardhurave nga aktiviteti i saj bankar gjatë vitit.

Ecuria pozitive pritet të vijojë edhe në tremujorin pasardhës duke treguar stabilitet dhe përforcuar më tej pozicionin e Bankës në tregun Bankar.

Bilanci Kontabël (Aktiv - Pasivet) dhe Zërat jashtë Bilancit

Kodi	AKTIVET (Në mijë Lekë)	TOTALI	
		Qershor 2026	Dhjetor 2025
01	VEPRIMET ME THESARIN DHE TRANSAKSIONET NDËRBANKARE	20,800,174	22,200,512
11	Arka dhe Banka Qendrore	19,059,236	18,537,925
12	Bono thesari dhe bono të tjera të pranueshme për rifinancim me Bankën Qendrore	-	-
13	Llogari rrjedhëse në bankat, instituc. e kreditit dhe instituc. e tjera financiare	436,162	918,584
14	Depozita me bankat, institucionet e kreditit dhe institucione të tjera financiare	558,408	1,670,131
15	Hua për bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	725,692	1,051,619
18	Llogari të tjera me bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	20,676	22,254
19	Llogari për t'u arkëtuar të dyshimta në bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	-	-
02	VEPRIMET ME KLIENTËT	132,602,021	124,222,651
20	Hua standarde dhe paradhënie për klientët	116,591,879	110,330,653
21	Hua dhe paradhënie të papaguara në afat për klientët	12,598,517	10,201,226
22	Hua dhe paradhënie në ndjekje	1,438,904	2,806,657
23	Hua nënstandard	1,735,194	755,929
24	Hua të dyshimta	237,527	128,186
25	Hua të humbura	(0)	0
26	Qeveria Shqiptare & Administrata Publike	-	-
27	Detyrimet ndaj klientëve për llogaritë rrjedhëse dhe depozitat	-	-
28		-	-
29	Llogari për t'u arkëtuar të klientëve përveç huave	-	-
03	VEPRIME ME LETRAT ME VLERË	48,898,783	47,799,619
31	Letra me vlerë me të ardhura fikse	42,334,548	47,799,304
32	Letra me vlerë me të ardhura të ndryshueshme	-	-
34	Letra me vlerë të blera dhe të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes	6,564,234	-
35	Garancia e ofruar për transaksionet me letrat me vlerë	-	-
36	Çmimet (primet) për instrumentet financiare	-	315
04	MJETE DHE DETYRIME TË TJERA	1,354,023	1,355,625
41	Mjete të tjera	858,423	746,691
43	Transaksionet si agjent	-	-
44	Llogari pezull dhe të pozicionit	462,248	608,935
45	Tatim i vlerës së shtuar	33,352	-
05	MJETET E QËNDRUESHME DHE BURIMET E PËRHERSHME	5,715,166	5,814,719
51	Interesa pjesëmarrëse	-	-
52	Filiale	-	-
53	Mjete të qëndrueshme	5,715,166	5,814,719
		-	-
	TOTALI	209,370,167	201,393,126

Kodi	PASIVET (Në mijë Lekë)	TOTALI	
		Qershor 2026	Dhjetor 2025
01	VEPRIMET E THESARIT DHE TRANSAKSIONET NDËRBANKARE	13,574,099	2,998,522
11.2	Banka Qendrore	518,887	452,260
12	Bono thesari dhe bono të tjera të përshtatshme për rifinancim me Bankën Qendrore	1,213,560	112,509
13	Llogari rrjedhëse me bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	712,678	305,901
16	Depozita nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	2,336,992	1,762,176
17	Hua marrë nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	8,529,473	364,675
18	Llogari të tjera me bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	262,509	1,000
2	VEPRIMET ME KLIENTËT	164,113,079	158,508,033
26	QEVERIA SHQIPTARE DHE ADMINISTRATA PUBLIKE	21,970	29,853
27	Detyrime ndaj klientëve për llogaritë rrjedhëse dhe depozitat	162,821,771	157,932,595
28	Llogari të tjera të klientëve	1,269,337	545,585
3	VEPRIME ME LETRAT ME VLERË	-	-
33	Borxh i përfaqësuar nga letrat me vlerë	-	-
34	Letra me vlerë të blera dhe të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes	-	-
35	Garancia e ofruar për transaksionet me letrat me vlerë	-	-
36	Çmimet (primet) për instrumentat financiare	-	-
4	MJETE DHE DETYRIME TË TJERA	2,105,976	1,585,545
42	Detyrime të tjera	1,052,290	1,020,489
43	Transaksionet si agjente	234,936	206,793
44	Llogaritë e marrëdhënieve	3,820	698
45	Llogaritë pezull dhe të pozicionit	814,931	356,150
46	Tatimi i vlerës së shtuar	-	1,416
5	MJETE TË QËNDRUESHME DHE BURIME TË PËRHERSHME	29,560,108	38,299,009
54	Ndihma dhe financimi publik	-	-
55	Fondet rezervë specifike	1,444,370	1,424,039
56	Borxhi i varur	1,022,547	3,958,248
57	Kapitali i aksionerëve	27,093,191	32,916,721
57.1	Kapitali i paguar	6,740,900	6,740,900
57.2	Primet e aksioneve	1,750	1,750
57.3	Rezerva	8,978,758	8,822,860
57.4	Diferenca e rivlerësimit	-	-
57.7	Fitimi (humbja) i pashpërndarë	9,509,724	12,325,902
57.8	Fitimi (humbja) i vitit ushtrimor	1,862,059	5,025,310
	TOTALI	209,370,167	201,393,126

Kodi	ZËRAT JASHTË BILANCIT (Në mijë Lekë)	TOTALI	
		Qershor 2026	Dhjetor 2025
90	ANGAZHIME FINANCIMI	9,519,376	9,258,019
91	GARANCITË	377,489,582	394,918,751
92	ANGAZHIME PËR LETRAT ME VLERË	6,582,712	
93	TRANSAKSIONE NË VALUTË	(18,255)	(279)
94	ANGAZHIME TË TJERA	40,977	41,493
95	ANGAZHIME PËR INSTRUMENTET FINANCIARE	-	-
	TOTALI	393,614,392	404,217,983

Zerat kryesore te aktiveve dhe pasiveve sipas Sistemit te Raportimit te Unifikuar:

1. Veprime me thesarin dhe transaksione ndërbankare	*1. Veprime me thesarin dhe transaksione ndërbankare*
2. Veprime me klientët	*2. Veprime me klientët*
3. Veprime me letra me vlerë	*3. Veprime me letra me vlerë*
4. Mjete të tjera	*4. Detyrime të tjera*
5. Mjete të qendrueshme	*5. Burime te përhershme*

04

PASQYRA E LLOGARISË "TË ARDHURA DHE SHPENZIME" DHE TREGUESIT E RENTABILITETIT

Kodi	LLOGARIA FITIM E HUMBJE (Në mijë Lekë)	TOTALI	
		Qershor 2026	Qershor 2025
60	Shpenzime të veprimtarisë bankare	**1,514,096**	**950,306**
60.1	Shpenzime për interesa	**749,100**	**476,036**
60.2	Humbje nga veprimet me letrat me vlerë dhe veprimet financiare	**287,869**	**138,513**
60.3	Komisione	**470,202**	**307,488**
60.4	Shpenzime për operacionet e qirasë	-	-
60.5	Shpenzime të tjera të veprimtarisë bankare	**6,925**	**267,686**
60.6	Humbje nga veprimet me valutat	-	-
61	Shpenzime për personelin	**941,918**	**929,497**
62	Taksa të tjera përveç taksave mbi të ardhurat	**9,607**	**9,927**
63	Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë	**1,103,528**	**927,638**
64	Amortizimi dhe fondet rezervë për zhvlerësimin e mjeteve të qëndrueshme	**235,862**	**216,159**
65	Humbje nga llogaritë për t'u arkëtuar të pambledhshme shpenzime per fonde rezervë	**2,035,833**	**1,467,544**
66	Shpenzime të jashtëzakonshme	-	-
67	Taksa mbi të ardhurat	**384,851**	**450,321**
68	Fitimi i vitit në vazhdim	**1,862,059**	**2,852,826**
	TOTALI I SHPENZIMEVE	8,087,753	7,804,218
70	Të ardhura të veprimtarisë bankare	**6,047,974**	**5,943,523**
70.1	Të ardhura nga interesat	**3,584,059**	**3,769,232**
70.2	Të ardhura nga veprimet me letrat me vlerë dhe veprimtaritë e tjera financiare	**982,870**	**959,818**
70.3	Komisione për shërbime bankare	**1,097,127**	**804,322**
70.4	Të ardhura nga veprimet e qirasë	**73,746**	**75,667**
70.5	Të ardhura të tjera të veprimtarisë bankare	**14,332**	**54,796**
70.6	Fitime nga veprimet me valutat	**295,839**	**279,688**
74	Transferime nga fondet rezervë për zhvlerësimin e mjete të qëndrueshme	-	-
75	Transferime nga fondet rezervë për zhvlerësimin e llogarive për t'u arkëtuar	**1,937,408**	**1,783,136**
76	Të ardhura të jashtëzakonshme	**102,372**	**77,559**
77	Humbja e vitit në vazhdim	-	-
	TOTALI I TË ARDHURAVE	8,087,753	7,804,218

Me siper paraqitet pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve per vitin 2025 dhe 2024

	TREGUESIT E RENTABILITETIT	Qershor 2026	Qershor 2025
1	Kthyeshmëria nga aktivet mesatare (ROAA) = të ardhurat neto / aktivet mesatar *100	**1%**	**1%**
2	Rezultati neto i jashtëzakonshëm / aktivet mesatare	**0%**	**0%**
3	Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë / të ardhurat bruto të veprimtarisë	**51 %**	**41%**
4	Të ardhurat neto nga interesi / shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë	**167%**	**205%**
5	Kthyeshmëria nga kapitali aksionar mesatar (ROAE) = të ardhurat neto / kapitali aksioner mesatar *100	**7%**	**9%**
6	Aktive për punonjës = totali i aktiveve/ numri i regjistruar i punonjësve	**258,801**	**248,123**
7	Të ardhurat neto nga interesat / aktivet mesatar	**2%**	**2%**
8	Të ardhurat nga interesat / aktivet mesatar	**2%**	**2%**
9	Shpenzime për interesa / aktivet mesatar	**0%**	**0%**
10	Të ardhurat neto nga interesat / të ardhurat bruto të veprimtarisë	**86 %**	**84%**
11	Të ardhurat neto nga veprimtaritë e tjera / aktivet mesatar	**1%**	**1%**
12	Shpenzimet jo për interesa / të ardhurat bruto të veprimtarisë	**69%**	**55%**
13	Shpenzime personeli / të ardhurat bruto të veprimtarisë	**21%**	**18%**
14	Shpenzime për provigjone / aktivet mesatar	**0%**	**0%**

Më sipër paraqiten treguesit kryesorë të rentabilitetit sipas rregullores nr. 60, "Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja".

05

STRUKTURA E KAPITALIT RREGULLATOR

Struktura e Kapitalit Rregullator
Mjaftueshmeria e Kapitalit

Kapitali Rregullator i Bankës në fund të muajit Qershor 2026 arriti vlerën e 24.932 miliard LEK.

Krahasur me vlerën e Kapitalit në Dhjetor 2025, është vërejtur një ulje prej 18.20% e cila vjen si pasojë e uljes së rezervave (përveç rezervave të rivlerësimit). E megjithatë mjaftueshmëria e kapitalit mbetet përsëri në nivele të kënaqshme, mbi nivelin minimal të përcaktuar nga Banka Qendrore.

Kjo përllogaritje është bërë sipas kërkesave të Bankës së Shqipërisë në rregulloren për "Kapitalin Rregullator të Bankës. Zërat përbërës të Kapitalit Rregullator të Bankës për periudhën përkatëse janë si më poshtë:

- *Kapitali i Paguar*
- *Primet e Aksioneve*
- *Rezervat*
- *Diferenca rivlerësimi kreditore*

Mbështetur në rregullore, këtyre zërave u jane zbritur:

- *Humbjet e pashpërndara të mbartura*
- *Aktive të patrupëzuara*

KAPITALI RREGULLATOR PËR MBULIMIN E RISQEVE TË KREDISË Treguesi (në mijë lekë)	Qershor 2026	Dhjetor 2025
KAPITALI BAZË		
KAPITALI RREGULLATOR	***24,932,649.42***	***30,481,089.42***
KAPITAL I NIVELIT TE PARE	***23,983,707.91***	***29,434,079.36***
KAPITAL BAZE I NIVELIT TË PARË	***23,983,707.91***	***29,434,079.36***
Instrumenta të kapitalit të njohura si Kapital Bazë i Nivelit të Parë (KBN1)	***6,742,650.00***	***6,742,650.00***
Kapitali i paguar	***6,740,900.00***	***6,740,900.00***
Zëra memorandumi: Instrumenta kapitali jo të njohura		
Primet e aksioneve	***1,750.00***	***1,750.00***
Fitimet e pashpërndara	***9,509,723.75***	***15,140,753.84***
Fitimet e pashpërndara dhe humbjet e mbartura nga periudhat e mëparshme	***9,509,723.75***	***12,325,901.84***
Fitimi ushtrimor i fundit të vitit	-	-
Fitimi ushtrimor i periudhës raportuese	-	***2,814,852.00***
Rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit)	***8,978,758.47***	***8,822,859.79***
Diferenca rivlerësimi kreditore	-	-
Rregullime të KBN1 lidhur me filtrat prudencialë	-	-
(-) Emri i mirë	-	-
(-) Aktive të tjera të patrupëzuara	***(1,247,424.31)***	***(1,272,184.27)***
(-) Shuma bruto e aktiveve të tjera të patrupëzuara	***1,247,424.31***	***1,272,184.27***
KAPITALI I NIVELIT TË DYTË	***948,941.51***	***1,047,010.06***

Më sipër paraqitet struktura e kapitalit rregullator rregullores Nr 69 për "Kapitalin Rregullator të Bankave"
Kapitali rregullator është kapitali që shërben për mbulimin e rrezikut të kredisë, të rreziqeve të tregut dhe të rrezikut operacional.

Kapitali rregullator në varësi të karakteristikave të tij dhe kushteve të përcaktuara në këtë rregullore, ndahet në kapitali i nivelit të parë dhe kapitali i nivelit të dytë.
Zerat kryesore jane Kapitali i paguar, Fitimet dhe humbjet e pashparnadara, rezervat dhe aktivet e patrupezuara.

06

MJAFTUESHMËRIA E KAPITALIT

Mjaftueshmëria e kapitalit

Mjaftueshmëria e kapitalit i referohet mjaftueshmërisë së burimeve kapitale të Bankës për të mbuluar rreziqet e kreditit dhe të tregut që vijnë nga portofoli i aktiveve të Bankës si dhe nga angazhimet e njohura në llogaritë jashtë bilancit.

Në përputhje me kërkesat e Bankës Qëndrore, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit bazuar në rrezikun e Bankës më **30 Qershor ishte 18.66%.** Banka Qëndrore kërkon që norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të jetë të paktën 12% e aktiveve të ponderuara me rrezikun.

RAPORTI I MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT (në mijë lekë)		Shuma	
		Qershor 2026	Qershor 2025
01.	Kapitali rregullator	*24,932,649.42*	*30,481,089.42*
02.	Aktivet dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik	*116,637,379.32*	*111,026,085.80*
03.	Raporti i Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë/Aktive të ponderuara me rrezikun	*18.66*	*23.23*
04.	Raporti i Kapitalit të Nivelit të Parë/Aktive të ponderuara me rrezikun	*18.66*	*23.23*
05.	Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (2/1)*100	*18.66*	*23.23*

AKTIVET DHE ZËRAT JASHTË BILANCIT TË PONDERUARA ME RREZIK (NË MIJË LEKË)		Shuma	
		Qershor 2026	Qershor 2025
1. Aktivet dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik për rrezikun e kredisë	*(a)*	*116,637,379.32*	*111,026,085.80*
02. 12.5 * kërkesa për kapital për rrezikun e tregut	*(b)*	-	-
03. 12.5 * kërkesa për kapital për rrezikun operacional	*(c)*	*17,013,562.90*	*17,013,562.90*
04. Shtesat për rritjen në klasat në "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimet me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë	*(d)*	-	-
5. Pakësimet për rritjen e portofolit të kredisë brenda vendit për vitin 2025	*(e)*	-	-
(TOTAL) Aktivet dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik	*(a+b+c+d-e)*	*133,650,942.22*	*128,039,648.70*

Më sipër paraqitet raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit, i llogaritur sipas rregullores Nr. 48 për "Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit". Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit llogaritet si raport ndërmjet shumës së kapitalit rregullator me shumën e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, e shprehur në përqindje.

Zërat kryesore janë Aktivet dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik, për rrezikun e kredisë, kërkesa për kapital për rrezikun e tregut, kërkesa për kapital për rrezikun operacional dhe Kapitali Rregullator.

07

MJAFTUESHMËRIA E KAPITALIT PËR RREZIKUN E KREDISË, RREZIKUN E TREGUT DHE RREZIKUN OPERACIONAL

INFORMACION I PËRGJITHSHËM CILËSOR PËR EKSPOZIMIN NDAJ RREZIQEVE

Përdorimi i instrumentave financiarë e ekspozojnë Bankën ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- *rreziku kreditor*
- *rreziku i likuiditetit*
- *rreziku i tregut*
- *rreziku operacional*

Ky shënim jep informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj secilit prej llojeve të rreziqeve të mësipërm, objektivat e Bankës, politikat dhe proceset për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut si dhe menaxhimin e kapitalit të Bankës.

Bordi Drejtues ka përgjegjësi për ndërtimin dhe vëzhgimin e strukturës së administrimit të rrezikut. Bordi ka themeluar Komitetin e Aktiveve dhe Detyrimeve (KAD) dhe Komitetin e Kredisësë Bankës, dhe atë Operacional, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të rrezikut në fushat e tyre specifike. Komitetet përbëhen nga anëtarë ekzekutiv dhe jo-ekzekutiv dhe raportojnë rregullisht tek Bordi Drejtues.

Politikat e administrimit të rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga Banka, për të vendosur kufizime dhe kontrolle dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontrolleve. Politikat e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e tregut. Banka nëpërmjet trajnimeve dhe standardeve dhe proçedurave drejtuese, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv në të cilin çdo punonjës të kuptojë rolin dhe detyrimet përkatëse.

Komiteti i kontrollit është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë me politikat dhe proçedurat e administrimit të rrezikut dhe për të vlerësuar mjaftueshmërinë e strukturës së administrimit të rrezikut në lidhje me rreziqet e hasura nga Banka. Për të kryer funksionet e veta Komiteti i Kontrollit mbështetet nga Kontrolli i Brendshëm i Bankës. Kontrolli i brendshëm vëzhgon në mënyrë të rregullt dhe 'ad-hoc' politikat dhe proçedurat e administrimit të rrezikut dhe raporton rezultatet e vëzhgimeve tek Komiteti i Kontrollit.

RREZIKU I KREDISË

Në aktivitetin normal të biznesit të saj, Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë në huadhëniet dhe paradhëniet ndaj klientëve dhe institucioneve financiare, investimet në letra me vlerë dhe zërave të tjerë jashtë bilancit. Rreziku i kredisë është risku i një humbjeje financiare të Bankës nëse një klient ose palë e ngjashme që posedon një instrument financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktore që burojnë kryesisht nga huadhënia e Bankës ndaj klientëve, institucioneve financiare ose që burojnë nga zëra të tjerë jashtë bilancit.

Për arsye raportimi të menaxhimit të riskut Banka konsideron dhe konsolidon të gjithë elementet e ekspozimit të kredisë ndaj riskut (risku individual i mos përmbushjes së detyrimeve, risku i sektorëve të ekonomisë si dhe risku lokal). Banka e menaxhon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë periodikisht duke monitoruar nga afër limitet e kredisë, portofolin e huave dhe përqendrimin e ekspozimit.

Këshilli Drejtues i Bankës i ka deleguar përgjegjësi për marrjen e vendimeve Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv (DPE), i cili i ka deleguar Komitetit të Kredisë kompetenca për vendimmarrje. Divizioni për Administrimin e Riskut, i cili raporton tek DPE, është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe administrimin e rrezikut të kredisë së Bankës, duke përfshirë detyrat e mëposhtme:

- *Formulimin e politikave të kredisë duke u konsultuar me njësitë e biznesit, mbulimin e kërkesave për kolateral, vlerësimin e kredisë, përcaktimin e nivelit të riskut dhe raportimin e tij, procedurat e dokumentimit dhe ato ligjore, si dhe përputhshmërinë me kërkesat rregullative dhe statutore.*

- *Rishikimin dhe vlerësimin e riskut të kredisë. Departamenti i Riskut të Kredisë të Bankës vlerëson të gjitha ekspozimet e kredisë përpara angazhimit me klientë nga Banka. Rinovimet dhe rishikimet e kushteve të kredive janë objekt i të njëjtit proces rishikimi.*

- *Kufizimi i përqendrimit të ekspozimit ndaj palëve, sipas shpërndarjes gjeografike dhe industrisë, (për huadhënie dhe paradhënie) si dhe sipas lëshuesit, kategorisë së klasifikimit të kredisë, likuiditetit të tregut dhe vendit (për investimet në letrat me vlerë).*

- *Zhvillimi dhe mirëmbajtja e klasifikimit të riskut të Bankës në mënyrë që të kategorizojë ekspozimet sipas nivelit të riskut të humbjes financiare që përballet si dhe të fokusojë menaxhimin e rreziqeve të tjerë shoqërues. Klasifikimi i riskut përdoret për të përcaktuar nevojën e provigjionimit të nevojshëm të dëmeve ndaj ekspozimeve specifike të kredisë.*

MJAFTUESHMËRIA E KAPITALIT PËR RREZIKUN E KREDISË, RREZIKUN E TREGUT DHE RREZIKUN OPERACIONAL

KODI	AKTIVET DHE ZËRAT JASHTË BILANCIT TË PONDERUARA ME RREZIK SIPAS KLASASVE TE EKSPOZIMEVE	Shuma	
		Qershor 2026	Qershor 2025
	KAPITALI RREGULLATOR	24,932,649	30,481,089
	RMK (%)	18.66	23.23
	SHUMA TOTALE E EKSPOZIMEVE TË PONDERUARA ME RREZIK	133,650,942	131,230,044
	RREZIKU I KREDISË		
01	**Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rrezikun e kredisë, kundërpartisë dhe rrezikun e shlyerjes së transaksioneve jo-DVP - Metoda Standarde (SA)**	116,637,379	111,026,086
1.1	Klasat e ekspozimit sipas SA duke përjashtuar pozicionet e titullzimit	116,637,379	111,026,086
1.1.1	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;	6,023,812	3,604,523
1.1.2	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale;	-	-
1.1.3	**Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jotregtare (organizatat joqeveritare/jofitimprurëse);**	26,455	31,536
1.1.4	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit	-	-
1.1.5	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare	-	-
1.1.6	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura	3,277, 783	3,704,430
1.1.7	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave)	58,821,476	57,656,133
1.1.8	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail)	20,826,215	18,999,993
1.1.9	Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme	19,838,579	19,283,743
1.1.10	Ekspozime (kredi) me probleme	1,995,910	887,403
1.1.11		53,602	79,360
1.1.12	Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara	-	-
1.1.13	Ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SiK	-	-
1.1.14	Zëra të tjerë	5,773 ,547	6,778,965
1.2	Pozicionet e titullzimit SA		
1.2*	nga të cilat: rititullzime		

KODI	RREZIQET E TREGUT	Shuma	
		Qershor 2026	Qershor 2025
2	Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rreziqet e tregut	-	*3,190,395*
2.1	Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e shlyerjes	-	-
2.1.1		-	-
2.1.2	Rreziku i shlyerjes në librin e tregtueshëm	-	-
2.2.1	**Rreziku i pozicionit të titujve të borxhit**	-	*3,190,395*
2.2.2	Rreziku i pozicionit të instrumenteve të kapitalit	-	-
2.2.3	Rreziku i kursit të këmbimit	-	-
2.2.4	Rreziku i investimeve në mallra	-	*3,190,395*
2.3	**Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun e përqendrimit në librin e tregtueshëm**	-	-

KODI	RREZIKU OPERACIONAL	Shuma	
		Qershor 2026	Qershor 2025
3.	Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun operacional	*17,013,563*	*17,013,563*
3.1	Metoda e Treguesit Bazik (BIA)	-	-
3.2	Metoda Standarde / Standarde Alternative	*17,013,563*	*17,013,563*

KODI	AKTIVET DHE ZËRAT JASHTË BILANCIT TË PONDERUARA ME RREZIK SIPAS KLASAVE TË EKSPOZIMEVE	Shuma	
		Qershor 2026	Qershor 2025
4	Shtesat për rritjen në klasat në "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimet me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë		
4.1	Totali i zërave të aktivit i "Veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimeve me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë, Mars 2026	-	-
4.2	Totali i zërave të aktivit i "Veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimeve me letrat me vlerë", jorezidente në valutë në periudhën raportuese	-	-
4.4	Totali i zërave të pasivit i "Veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimeve me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë, Mars 2026		
4.5	Totali i zërave të pasivit i "Veprimeve me thesarin dhe transaksioneve ndërbankare" dhe "Veprimeve me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë, në periudhën raportuese	-	-
4.6	Rritja e zërave të pasivit i "Veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimeve me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë	-	-

KODI	AKTIVET DHE ZËRAT JASHTË BILANCIT TË PONDERUARA ME RREZIK SIPAS KLASAVE TË EKSPOZIMEVE	Shuma	
		Qershor 2026	Qershor 2025
5	Pakësimet për rritjen e portofolit të kredisë brenda vendit për vitin 2026		
5.1	Portofoli i kredisë bruto, në Qershor 2026	-	-
5.2	Portofoli i kredisë bruto, në periudhën raportuese 2026	-	-
5.3	Rritja e portofolit të kredisë, 2026	-	-
5.4	Rritja e portofolit të kredisë për 2026-ën që plotëson kushtet për t'u zbritur nga totali i aktiveve të ponderuara me rrezik	-	-
5.4.1	nëse periudha raportuese është Qershor, 2026	-	-
5.4.2	nëse periudha raportuese është Qershor, 2026	-	
5.5	nëse periudha raportuese është Qershor, 2026	-	-
5.6	nëse periudha raportuese është Qershor, 2026	-	-
5.5	4% e portofolit të kredisë së Qershor, 2026	-	-
5.6	10% e portofolit të kredisë së Qershor, 2026	-	-
5.7	Rritja vjetore e portofolit të kredisë	-	-
5.7.1	nëse periudha raportuese është Qershor, 2026	-	-
5.7.2	nëse periudha raportuese është Qershor, 2026	-	-
5.7.3	nëse periudha raportuese është Qershor, 2026	-	-
5.7.4	nëse periudha raportuese është Qershor 2026		

Sipas rregullores Nr. 48 për "Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit", bankat llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, sipas Metodës Standarde. Për llogaritjen e shumave të ekspozimit të ponderuara me rrezikun, do të zbatojnë peshat e rrezikut të përcaktuara për të gjitha ekspozimet. Bankat i klasifikojnë ekspozimet dhe ekspozimet e mundshme të zërave brenda dhe jashtëe bilancit, sipas klasave të ekspozimit si më poshtë:

- *ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;*
- *ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale;*
- *ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jotregtare (organizatat joqeveritare/jofitimprurese);*
- *ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit;*
- *ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare;*
- *ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura;*
- *ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave);*
- *ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofolëve të klientëve individë (retail);*
- *ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme;*
- *ekspozime (kredi) me probleme;*
- *ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë;*
- *ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara;*
- *ekspozime në pozicione të krijuara nga titullzimi (securitization);*
- *ekspozime në formen e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SIK; dhe/ose*
- *zëra të tjerë.*

Bankat, për qëllime të llogaritjes së kërkesës për kapital për rrezikun e tregut, përfshijnë në "librin e tregtueshëm" të gjitha pozicionet në instrumentet financiare e në mallra (commodities), të mbajtura me qëllim tregtimin e tyre ose mbrojtjen e elementeve të tjerë të librit të tregtueshëm. Këto instrumente duhet të jenë të çliruara nga çdo lloj klauzole/dispozite kufizuese, për sa i përket tregtueshmërisë së tyre ose aftësisë së tyre për t'u mbrojtur tërësisht

Rreziku Operacional është rreziku që subjekti të pësojë humbje, si rezultat i papërshtatshmërisë ose dështimit të proceseve të brendshme dhe të sistemeve, gabimeve njerëzore, apo i ngjarjeve të jashtme. Rreziku operacional përfshin dhe rrezikun ligjor, por përjashton rrezikun reputacional dhe strategjik. Bankat llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun operacional, sipas metodës së treguesit të thjeshtë, e cila konsideron të ardhurën neto nga veprimtaria bankare për tre vitet e fundit të veprimtarisë së bankës dhe një koeficient α prej 15%.

Rreziku i kredisë (vazhdim)

- Rishikimin dhe vlerësimin e riskut të kredisë. Departamenti i Riskut të Kredisë të Bankës vlerëson të gjitha ekspozimet e kredisë përpara angazhimit me klientë nga Banka. Rinovimet dhe rishikimet e kushteve të kredive janë objekt i të njëjtit proces rishikimi.

- Kufizimi i përqendrimit të ekspozimit ndaj palëve, sipas shpërndarjes gjeografike dhe industrisë, (për huadhënie dhe paradhënie) si dhe sipas lëshuesit, kategorisë së klasifikimit të kredisë, likuiditetit të tregut dhe vendit (për investimet në letrat me vlerë).

- Zhvillimi dhe mirëmbajtja e klasifikimit të riskut të Bankës në mënyrë që të kategorizojë ekspozimet sipas nivelit të riskut të humbjes financiare që përballet si dhe të fokusojë menaxhimin e rreziqeve të tjerë shoqërues. Klasifikimi i riskut përdoret për të përcaktuar nevojën e provigjionimit të nevojshëm të dëmeve ndaj ekspozimeve specifike të kredisë.

Në përputhje me metodologjinë e Bankës të gjitha ekspozimet janë të klasifikuara si ekspozime pa probleme dhe me probleme. Banka klasifikon portofolin e ekspozimeve duke u bazuar në Rregulloren Nr. 62 Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja. Këto rregulla përfshijnë faktet objektive si: shkelja e kontratës, moskryerja e pagesave të interesit dhe principalit; vështirësi të mëdha financiare të huamarrësit; dhe informacione të tjera të rëndësishme financiare për klientin.

- Rishikimi i përputhshmërisë së njësive të biznesit me limitet e ekspozimit të miratuara duke përfshirë ato për industritë e zgjedhura dhe llojet e produkteve. Komitetit të Cilësisë së Aktiveve i sigurohen raporte mujore të detajuara mbi cilësinë e kredive të portofoleve lokale ku gjithashtu paraqitet dhe tendenca e tyre dhe veprimet rregulluese të duhura që duhen ndërmarrë.

- Ofrimi i konsultave, drejtimi dhe aftësi profesionale ndaj njësive të biznesit për të promovuar në Bankë praktikën më të mirë të menaxhimit të rrezikut të kredisë.

Banka monitoron përqendrimet e riskut të kredisë sipas sektorëve dhe vendit.
Banka përcakton një fond për humbjet nga zhvlerësimi i kredive që përfaqëson një përllogaritje për humbjet në portofolin e kredive.
Provizionet përcaktohen duke përdorur përqindjet e përcaktuara bazuar ne Rregulloren Nr. 62 Për administrimin e rrezikut te kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja.

Normat e llogaritjes së fondeve rezervë përcaktohen si më poshtë:

Lloji i kredisë	*Ditë vonesat për kredi*	*Ditë vonesat për overdrafte*	*Provigjioni i humbjes*
Standarde	*0-30 ditë*	*0-30 ditë*	*1-10%^1*
Në ndjekje	*31-90 ditë*	*31-60 ditë*	*5-10%^2*
Nënstandarde	*91-180 ditë*	*61-90 ditë*	*20%*
Të dyshimta	*181-365 ditë*	*91-180 ditë*	*50%*
Të humbura	*Mbi 365 ditë*	*Mbi 181 ditë*	*100%*

1) Banka aplikon provigjion prej 10% mbi ekspozimet e risturkturuara dhe minimumin prej 1% në klasën standarte
2) Banka aplikon provigjion prej 10% mbi ekspozimet e risturkturuara dhe minimumin prej 5% në klasën në ndjekje

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është përcaktuar si paaftësia e mundshme e një institucioni për të plotësuar detyrimet që ka për pagesa për shkak të paaftësisë për të likuiduar aktive ose për të siguruar financim të mjaftueshëm nga tregu (rreziku i likuiditetit nga financimi), ose për shkak të vështirësive që lidhen me konvertimin e pozicionit të aktiveve financiare që shoqërohen me ndryshime të rëndësishme negative të çmimeve, për shkak të kushteve të papërshtatshme ose çrregullimeve të përkohshme të tregut.

Metoda e Bankës për menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë sa më shumë të jetë e mundur, likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet e saj kur duhet, në kushte si normale dhe jonormale, pa pësuar humbje të papranueshme ose që rrezikojnë dëmtimin e reputacionit të Bankës. Banka përcakton udhëzimet për administrimin e rrezikut të likuiditetit dhe një plan emergjence.

Banka përllogarit dhe siguron në çdo kohë respektimin e treguesit të aktiveve likuide ndaj pasiveve afatshkurtra:

a) *në monedhën kombëtare (lekë) dhe në monedhë të huaj në nivelin minimal 15% (pesëmbëdhjetë përqind); dhe*

b) *në total në nivelin minimal 20% (njëzet përqind).*

Rreziku i tregut

Banka llogarit risk tregu vetëm për pozicionin e hapur valuator. Ne baze te rregullores për mjaftueshmerine e kapitalit banka llogarit kërkesë për kapital ne lidhje me riskun e tregut nëse pozicioni valutor është më shumë se 2% e kapitalit rregullator.

Rreziku operacional

Bankat llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun operacional sipas metodës së treguesit të thjeshtë, e cila konsideron të ardhurën neto nga veprimtaria bankare për tre vitet e fundit të veprimtarisë së bankës dhe një koeficient α prej 15%.

08

KLASIFIKIMET E PORTOFOLIT TË KREDISË SIPAS DEGËVE TË EKONOMISË DHE SHPËRNDARJES GJEOGRAFIKE

Klasifikimet e portofolit të Kredisë sipas degëve të Ekonomisë dhe shpërndarjes gjeografike

Kodi	Evidenca e kreditit sipas degëve të ekonomisë DEGËT E EKONOMISË	TEPRICA E KREDISË (në fund të muajit që raportohet)	PROVIGJIONI
01	BIZNESET	76,209,451	1,737,993
A.	Bujqësia, Pyjet, Peshkimi	696,821	4,806
B.	Industria nxjerrëse	303,746	8,958
C.	Industria përpunuese	8,535,411	330,105
D.	Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	9,903,395	135,362
E.	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	19,145	191
F.	Ndërtimi	10,249,095	198,139
G.	Tregtia me shumicë dhe me pakicë; Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	20,362,562	558,415
H.	Transporti dhe magazinimi	7,462,339	132,391
I.	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	9,975,582	215,401
J.	Informacioni dhe komunikacioni	1,536,444	71,252
K.	Aktivitete financiare dhe të sigurimit	432,345	11,628
L.	Aktivitete të pasurive të paluajtshme	2,067,157	20,155
M.	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	191 ,711	1,213
N.	Shërbime administrative dhe mbështetëse	1,332,994	13,075
O.	Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm	-	-
P.	Arsimi	779,523	7,277
Q.	Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	1,646,391	15,548
R.	Arte, argëtim dhe çlodhje	340,475	3,160
S.	Aktivitete të tjera shërbimi	374,314	10,915
T.	Aktivitetet të familjeve si punëdhënës; Aktivitete të prodhimit të mallrave e shërbimeve të pandryshueshme të familjeve për përdorimin e vet	-	-
U.	Aktivitete të organizatave dhe organizmave ndërkombëtare	-	-

Kodi	Evidenca e kreditit sipas degëve të ekonomisë DEGËT E EKONOMISË	TEPRICA E KREDISË (në fund të muajit që raportohet)	PROVIGJIONI
02	KORPORATA JOFINANCIARE PUBLIKE	243	2
B.	Industria nxjerrëse	-	-
C.	Industria përpunuese	-	-
D.	Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	243	2
E.	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	-	-
F.	Ndërtimi	-	-
G.	Tregtia me shumicë dhe me pakicë; Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	-	-
H.	Transporti dhe magazinimi	-	-
I.	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	-	-
J.	Informacioni dhe komunikacioni	-	-
K.	Aktivitete financiare dhe të sigurimit	-	-
L.	Aktivitete të pasurive të paluajtshme	-	-
M.	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	-	-
N.	Shërbime administrative dhe mbështetëse	-	-
O.	Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm	-	-
P.	Arsimi	-	-
Q.	Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	-	-
R.	Arte, argëtim dhe çlodhje	-	-
S.	Aktivitete të tjera shërbimi	-	-
T.	Aktivitetet të familjeve si punëdhënës; Aktivitete të prodhimit të mallrave e shërbimeve të pandryshueshme të familjeve për përdorimin e vet	-	-
U.	Aktivitete të organizatave dhe organizmave ndërkombëtare	-	-
03	INDIVIDËT	58,631,513	1,870,020.75
	TOTALI	134,841,208	3,608,016.42

9

KLASIFIKIMET E PORTOFOLIT TË KREDISË SIPAS DEGËVE TË EKONOMISË DHE SHPËRNDARJES GJEOGRAFIKE (VAZHDIM)

Klasifikimet e portofolit të Kredisë sipas degëve të Ekonomisë dhe shpërndarjes gjeografike

(Vazhdim)

EVIDENCA E KREDITIT SIPAS SHPËRNDARJES GJEOGRAFIKE	TOTALI	PROVIGJIONI
Rrethi Tiranë	100,074,243.74	2,272,403.44
Rrethi Durrës	9,203,120.58	309,696.43
Rrethi Elbasan	2,241,703.06	102,823.61
Rrethi Shkodër	3,145,599.82	63,285.87
Rrethi Korçë	1,252,159.30	101,721.19
Rrethi Vlorë	3,196,839.23	143,200.41
Rrethi Lushnjë	1,183,662.41	59,716.23
Rrethi Gjirokastër	620,590.75	16,940.24
Rrethi Fier	2,594,189.65	70,955.16
Rrethi Berat	1,072,039.35	32,256.44
Rrethi Pogradec	1,002,048.13	93,185,11
Rrethi Sarandë	1,224,046.18	34,916.19
Rrethi Peshkopi	895,400.40	24,221.82
Rrethi Kukës	-	-
Rrethi Lezhë	2,671,120.72	156,886.51
Rrethi Burrel	567,691.69	28,895.51
Rrethi Kavajë	1,234,883.18	29,425.51
Rrethi Përmet	-	-
Rrethi Gramsh	225,866.41	2,495.26
Rrethi Librazhd	590,949.45	22,356.27
Rrethi Devoll	-	-
Rrethi Kuçovë	226,525.46	5,302.10
Rrethi Ballsh	133,979.86	4,104.72
Rrethi Malësi e Madhe	-	-
Rrethi Delvinë	-	-
Rrethi Rreshen	-	-
Rrethi Laç	-	-
Rrethi Bilisht	264,050.20	6,410.82
Rrethi Bulqizë	-	-
Rrethi Ersekë	-	-
Rrethi Has	-	-
Rrethi Koplik	-	-
Rrethi Krujë	1,800,275.71	19,887.07
Rrethi Peqin	-	-
Rrethi Pukë	-	-
Rrethi Skrapar	-	-
Rrethi Tepelenë	145,932.14	6,930.50
Rrethi Tropojë	-	
TOTALI	135,566,899.42	3,608,016.42

10

KREDITË SIPAS KALIMIT TË AFATIT TË KTHIMIT. FONDET REZERVË PËR HUMBJET NGA KREDITË

Klasifikimet e portofolit te Kredise sipas maturitetit te mbetur.
Kredite sipas kalimit te afatit te kthimit. Fondet Rezerve per humbjet nga kredite

Kodi	KLASIFIKIME TË PORTOFOLIT TË KREDIVE SIPAS MATURITETIT TË MBETUR (KONTRAKTUAL).	DITË				MUAJ			VITE		TOTALI
	Treguesi (në mijë lekë)	1 (O/N)	2-7	8-15	16-30	1-3	3-6	6-12	1-5	> 5	
20	Hua standarde dhe paradhënie për klientët	20,397,017	592	5,713	9,223	143,641	294,802	1,486,264	28,876,706	77,976,438	**129,190,396**
22	Hua në ndjekje	37,642	126	113	339	1,657	4,084	17,794	579,560	797,590	**1,438,904**
23	Hua nënstandard	-	-	-	-	-	-	-	1,771,846	413,282	**2,185,129**
24	Hua të dyshimta	-	-	-	-	-	-	-	343,538	137,627	**481,165**
25	Hua të humbura	-	-	-	-	-	-	-	1,257,326	288,287	**1,545,613**
29	Llogari për t'u arkëtuar të klientëve në status të dyshimtë të ndry.nga huatë	-		-	-	-	-	-	-	-	**-**

Kreditë sipas kalimit të afatit të kthimit

KREDITË E KLASIFIKUARA SIPAS KALIMIT TË AFATIT TË KTHIMIT	KALUAR AFATI I KTHIMIT				TOTALI
Treguesi (në mijë lekë)	1-30 ditë	31-90 ditë	91-180 ditë	Mbi 180 ditë	
Hua afatshkurtra	36,412.32	697,798.50	23,216.18	181,711.06	***939,138.06***
Hua afatmesme	147,412.56	511,158.92	34,441.08	400,902.37	***1,093,914.93***
Hua afatgjatë	530,789.65	833,951.19	332,208.99	707,629.82	***2,404,579.64***
Hua për prona të patundshme	709,338.55	126,083.42	85,194.10	233,020.00	***1,153,636.07***
Kontrata qiraje	-	-	-	-	**-**
Punonjës banke	-	-	-	-	**-**
(TOTALI)	1,423,953.07	2,168,992.03	475,060.36	1,523,263.25	5,591,268.71

FONDET REZERVË TË KRIJUARA NGA BANKA

Kodi	LLOGARITË	Teprica në fillim	Shtimi i provigjonv.	Rimarrje e provigjonv.	Kreditë e fshira gjatë periudhës	Korigjime të tjera gjatë periudhës	Teprica në fund
128	FR për zhvlerësimin e bonove të përshtatshme për rifinancim me Bankën Qendrore	-	-	-	-	-	-
198		-	-	-	-	-	-
238	FR për mbulimin e humbjeve nga huatë nënstandard	416,223	102,185	63,173	-	(5,300)	449,935
248	FR për mbulimin e humbjeve nga huatë e dyshimta	205,779	84,403	45,394	-	(1,151)	243,638
258	FR për mbulimin e humbjeve nga huatë e humbura	2,390,208	42,454	875,683	765,169	(11,365)	1,545,613
268	FR mbulimin e humbjeve nga llogaritë për t'u arkëtuar prej Qeverisë Shqiptare e org. tjera publike me status të dyshimtë	-	-	-	-	-	-
298	FR për llogaritë për t'u arkëtuar të klientëve në status të dyshimtë përveç huave	-	-	-		-	-
3128	FR për të mbuluar zhvlerësimin	215,258	0	193,520	-	(1,421)	20,317
3138	FR për të mbuluar zhvlerësimin	-	-	-	-	-	-
3222	FR për të mbuluar zhvlerësimin	-	-	-	-	-	-
418	FR për zhvlerësimin e mjeteve të tjera	641,131	4,989	5,846	-	(1,868)	638,407
518	FR për zhvlerësimin	-	-	-	-	-	-
528	FR për zhvlerësimin	-	-	-	-	-	-
538	FR për amortizimin e mjeteve të qëndrueshme	-	-	-	-	-	-
551	FR për rreziqe e shpenzime	1,321,729	328,543	253,569	-	(6,436)	1,390,268
558	FR specifike të tjera	78,382	25,978	-	-	(50,257)	54,102
	(TOTALI)	*5,268,709.77*	*588,552.78*	*1,437,184.73*	*765,169.32*	*(77,797.41)*	*4,342,280.41*

FONDET REZERVË PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NGA KREDITË

KLASIFIKIMI I KREDIVE	Kryegjëja	Norma për provigjone	Fonde rezervë për kryegjënë	Interesat e llogaritura	Norma për provigjone	F.R. për interesat
Kredi standarde dhe kredi e pakthyer në afat	128,948,910.75	1%	1,289,489.33	241,485.12	1%	2,416.54
Kredi standarde të ristrukturuara	-	0%	-	-	10%	-
Kredi në ndjekje	1,423,054.63	5%	76,135.10	15,849.49	5%	792.49
Kredi në ndjekje të ristrukturuara	-	0%	-	-	10%	-
Kredi nënstandarde	2,168,992.03	20%	433,798.40	16,136.72	100%	16,136.73
Kredi të dyshimta	475,054.82	50%	237,527.41	6,110.64	100%	6,110.64
Kredi të humbura	1,523,165.74	100%	1,523,165.74	22,447.61	100%	22,447.61
(TOTALI)	*134,539,178*		*3,560,115.98*	*302,029.57*		*47,904.00*

TEKNIKAT E ZBUTJES SË RREZIKUT

Politika e OBAs për kolateralin është pjesë përbërëse dhe e pandarë e administrimit të rrezikut të kredisë në OBA dhe dokumenti bazë për zbutjen e riskut të kredisë i cili përcakton rregullat/kushtet e brendshme për pranimin e një grupi standard të llojeve të kolateraleve, duke përfshirë gjithashtu edhe identifikimin e formave të pranueshme të kolateraleve.

Kolaterali/garancia pranohet vetëm për të mbështetur dhe siguruar kredinë dhe nuk shërbejnë për të zëvendësuar aftësinë e kredimarrësit për të përmbushur detyrimet. Për këtë arsye, ato duhet të vlerësohen gjatë procesit të aplikimit për kredi krahas vlerësimit të besueshmërisë dhe kapacitetit të kredimarrësit për ripagimin e kredisë.

Kjo politikë është në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit. OBA garanton integritetin e administrimit të garancive dhe kolateraleve në funksion të zbutjes së riskut të humbjeve të kredisë. Grupet kryesore të kolateraleve që pranon OBA janë si më poshtë:

- ***Kolateral Cash (mjete monetare)***
- ***Letra me vlerë***
- ***Të ardhura të arkëtueshme***
- ***Pasuri të paluajtshme***
- ***Pasuri të luajtshme***
- ***Garanci***
- ***Nota premtimi***
- ***Letër angazhimi***

Rregullat për një grup të pranuar dhe standard të llojeve të kolateralit që përdoren nga Banka për aktivitete kreditimi përshkruajnë dhe përcaktojnë:

- *Kushtet për zbatueshmërinë dhe ekzekutimin ligjor,*
- *Kushtet për procesin e vlerësimit dhe vlerat e pranuara nga Banka në fillim të procesit për lloje të caktuara kolaterali dhe,*
- *Kushtet për procesin e rivlerësimit*

OBA, në përputhje me Rregulloren për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit ka në fokus disa objektiva si më poshtë:

- *Të inkurajojë dhe garantojë menaxhim dhe administrim optimal*
- *Të maksimizojë efektin e zbutjes të kolateralit dhe garancitë për huat në vonesa*
- *Të përcaktojë rregullat e përgjithshme për pranimin, vlerësimin, monitorimin dhe administrimin e kolateralit (mbrojtjen me mbulim) dhe garancitë (mbrojtje pa mbulim), si dhe të përcaktojë në mënyrë të detajuar rregullat dhe kërkesat për kolateral/garanci specifike.*

OBA monitoron kërkesat e pranueshmërisë që duhet të plotësohen në bazë të rregullores së sipërpërmendur për mbrojtjen me mbulim dhe pa mbulim të kredisë.

Për qëllime të llogaritjes së efekteve të kolateralit financiar është përzgjedhur Metoda e Thjeshtë e Kolateralit Financiar. Tabela e mëposhtme paraqet vlerën e ekspozimit sipas klasave të kredisë të përcaktuar në rregulloren e mjaftueshmerisë së kapitalit si dhe vlerën e kolateralit të marr në konsideratë për secilën klasë ekspozimi.

NR.	KLASA E EKSPOZIMIT	Vlera Neto	Kolaterali i marrë në konsideratë sipas teknikave të zbutjes të kredisë
1	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;	29,744,708	-
2	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale	-	-
3	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare (organizatat joqeveritare/jofitimprurëse)	14,502,059	-
4	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit	-	-
5	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare	-	-
6	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura	26,455	-
7	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave)	-	-
8	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail)	9,534,040	6,800,185
9	Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme	90,903,421	1,078,519
10	Ekspozime (kredi) me probleme	892,477	-
11	Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë	32,925,177	302,339
12	Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara	-	-
13	Ekspozime në pozicione të krijuara nga titullzimi (securitization)	-	-
14	Ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SIK dhe/ose	-	-
15	Zëra të tjerë.	131,837,093	-

11

RREZIKU I NORMËS SË INTERESIT NË LIBRIN E BANKËS

Rreziku i Normës së Interesit në Librin e Bankës

Kodi	FORMA TOTALE E IRRBB-s	TOTALI I POZICIONEVE TË PONDERUARA	
	IRR	Monedha	Shuma
		1.00	2.00
1.1.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha LEK	ALL	**665,620**
1.2.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha EUR	EUR	**1,010,379**
1.3.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha USD	USD	**(88,276)**
1.4.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha të tjera	TE TJERA	**(36,213)**
2.	**NDRYSHIMI NË VLERËN E EKSPOZIMIT**		**1,551,510**
3.	KAPITALI RREGULLATOR (own funds)		**24,932,649**
4.	**(NDRYSHIMI NË VLERËN E EKSPOZIMIT / KAPITALI RREGULLATOR) * 100**		**6.22**

Bankat vlerësojnë burimet/format e ndryshme të rrezikut të normës së interesit, të cilat mund të ndikojnë negativisht në të ardhurat ose ekspozimin në librin e bankës. Burimet/format e rrezikut të normës së interesit përfshijnë:

a. rrezikun e riçmimit - është mundësia që banka të pësojë humbje financiare si rezultat i mospërputhjeve të maturitetit (për normat e interesit fikse) dhe i riçmimit të normave të interesit (për normat e ndryshueshme të interesit) të pozicioneve të librit të bankës

b. rrezikun e kurbës së kthimit - është mundësia që banka të pësojë humbje financiare si rezultat i ndryshimit të pjerrësisë së kurbës së kthimit/yield-it

c. rrezikun bazë - është mundësia që banka të pësojë humbje financiare si rezultat i ndryshimeve të normave referencë të interesit për instrumentet me karakteristika të ngjashme për nga maturiteti\ ose koha, deri në ndryshimin e ardhshëm të normës së interesit

d. rrezikun e opsioneve - është mundësia që banka të pësojë humbje financiare si rezultat i opsioneve të përfshira në pozicione të ndjeshme ndaj normës së interesit.

Sipas udhezimit Nr 33 per "Mbi Administrimin e Rrezikut te Normes se Interesit ne Librin e Bankes " bankat llogarisin ekspozimin ndaj rrezikut të normës së interesit në librin e bankës duke përdorur metodën e vlerësimit të ndryshimit në ekspozimin e librit të bankës, duke aplikuar një shock standard të normës së interesit në pozicionet e librit të bankës, në të gjitha monedhat kryesore individualisht, dhe në monedhat të tjera mbi baza të agreguara.

Bankat, për qëllime të llogaritjes sipas metodës së vlerësimit të ndryshimit të ekspozimit të librit të bankës, shpërndajnë pozicionet e ndjeshme ndaj normës së interesit, në 14 intervale kohore duke shpërndare pozicionet me normë interesi fikse në intervale kohore, sipas maturitetit të mbetur, dhe pozicionet me normë interesi të ndryshueshme në intervale kohore, sipas kohës, deri në ndryshimin e ardhshëm të normës së interesit. Bankat përdorin peshat e ponderuara të përcaktuara udhezim, të cilat llogariten si prodhim i shock-ut të normës së interesit prej 200 pikësh bazë (ose 2%) me kohëzgjatjen e modifikuar (estimated modified duration) për çdo interval kohor.

Raporti i ndryshimit të ekspozimit në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator nuk duhet të tejkalojë nivelin prej 20%.

12

RREZIKU I LIKUIDITETIT

Kodi	AKTIVET LIKUIDE - PASIVET AFATSHKURTRA (në mijë lekë)	LEKË	USD	EUR	TË TJERA	TOTALI
1	Arka	2,369,309.14	341,421.87	1,501,505.73	245,415.73	4,457,652.48
2	Llogaritë me Bankën e Shqipërisë, duke përfshirë rezervën e detyrueshme deri në masen e lejuar te perdorimit te saj, te percaktuar me akt nenligjor te Bankes se Shqiperise	2,875,953.38	2,306.64	113,976.51	-	2,992,236.52
3	Bonot e thesarit të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, të regjistruara në bilanc si "të tregtueshme"/"të vendosjes"	-	-	-	-	-
4	80 për qind të obligacioneve të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të regjistruara në bilanc si "të tregtueshme"/"të vendosjes"	-	-	7,582,908.56	-	7,582,908.56
5	Letra me vlerë "të investimit" të Qeverisë Shqiptare (bono thesari dhe obligacione) me maturim të mbetur deri në 1 (një) muaj	-	-	-	-	-
6	80 për qind të letrave me vlerë të qeverisë shqiptare (bono thesari dhe obligacione), që nuk bëjnë pjesë në kodin "3", "4" dhe "5", por që plotësojnë kriteret e rregulloreve të Bankës së SHqipërisë "Mbi garancitë në operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë" dhe 'Mbi marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes"	14,824,968.30	-	-	-	14,824,968.30
7	Bonot e thesarit të blera sipas marrëveshjeve të riblerjes, kur maturimi i mbetur i marrëveshjes së riblerjes është deri në 7 (shtatë) ditë	-	-	-	-	-
8	Llogaritë rrjedhëse në bankat dhe institucionet e tjera financiare	-	68,095.74	58,626.34	309,440.38	436,162.46
9	Depozita me bankat dhe institucionet e tjera financiare me maturim të mbetur deri në 7 (shtatë) ditë	-	181,808.00	376,560.00	-	558,368.00
10	Hua për bankat dhe institucionet e tjera financiare me maturim të mbetur deri në shtatë ditë (përjashtohet llogaria 157 "hua të pakthyera në afat ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare");	-	-	-	-	-
11	Letrat me vlerë "të tregtueshme"/"të vendosjes" të emetuara nga qeveritë qendrore dhe bankat qendrore me klasifikime nga agjencitë ndërkombëtare të rating-ut ekuivalente me klasifikimin e S&P jo më pak se A +;	-	-	4,132,835.16	-	4,132,835.16
12	Letra me vlerë "të tregtueshme"/"të vendosjes" të emetuara nga institucione financiare me vlerësim nga agjencitë ndërkombëtare të rating-ut ekuivalente me klasifikimin e S&P jo më pak se A+;	-	-	-	-	-
13	Letra me vlerë "të tregtueshme"/"të vendosjes" që nuk janë të vlerësuara, por të emetuara nga banka ndërkombëtare të zhvillimit të listuara në rregulloren e Bankës së Shqipërisë "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave";	-	-	-	-	-
14	Letra me vlerë "të investimit" me maturim të mbetur deri në 1 (një) muaj (duke perjashtuar letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare të përfshira në shkronjat e mësipërme)					-
15		-	-	-	6,563,140.61	6,563,140.61
A						
	TOTALI I AKTIVEVE LIKUIDE	**20,070,230.82**	**593,632.25**	**13,766,412.30**	**7,117,996.72**	**41,548,272.09**
B	TOTALI I PASIVEVE AFATSHKURTRA ME AFAT TË MBETUR MATURIMI DERI NË 1 VIT	**67,838,543.55**	**965,840.05**	**68,525,909.60**	**7,086,197.25**	**144,416,490.45**
C	TREGUESI I LIKUIDITETIT (në %)					
1	*Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (per monedhen kombetare LEK)*					**29.59%**
2	*Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (per monedhat e huaja)*					**28.05%**
3						**28.77%**

AKTIVET SIPAS MATURIMIT PËRFUNDIMTAR	DITË				MUAJ			VITE		TOTALI
Treguesi (në mijë lekë)	1 (O/N)	2-7	8-15	16-30	1-3	3-6	6-12	1-5	> 5	
TOTALI I AKTIVIT + TOTALI I ZERAVE JASHTE BILANCIT	51,964,073	6,564,952	5,826	9,562	1,410,878	446,154	8,228,609	50,549,246	102,551,280	**221,730,580**

PASIVET SIPAS MATURIMIT PËRFUNDIMTAR	DITË				MUAJ			VITE		TOTALI
Treguesi (në mijë lekë)	1 (O/N)	2-7	8-15	16-30	1-3	3-6	6-12	1-5	> 5	
TOTALI I PASIVIT + TOTALI I ZERAVE JASHTE BILANCIT	98,778,553	10,160,869	707,414	1,633,776	9,589,038	8,823,417	16,907,805	34,198,115	28,571,180	**209,370,167**

Rreziku i likuiditetit është mundësia e humbjes financiare si rezultat i mungesës së likuiditetit ,ku mungesë likuiditeti konsiderohet çdo situatë në të cilën banka nuk disponon aktive likuide të mjaftueshme ose ka vështirësi për t'i realizuar ato në treg, me qëllim përmbushjen e detyrimeve kur ato maturohen dhe kërkohen nga depozituesit ose kreditorët e tjerë, ose nuk ka mundësi të financojë rritjen e aktiveve të veta.

Sipas rregullores Nr 71 per "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit" bankat përllogarisin dhe sigurojnë në çdo kohë respektimin e treguesit të aktiveve likuide ndaj pasiveve afatshkurtra:

***a.** në monedhën kombëtare (lekë) dhe në monedhë të huaj në nivelin minimal 15%; dhe*
***b.** në total në nivelin minimal 20% (njëzet për qind).*

Në aktiveve likuide përfshihen zërat qe paraqiten ne tabelen e mësipërme te cilat konsiderohen aktive me likuiditet të lartë dhe përfshihen si të tilla vetëm në rastin kur mbi to nuk ekziston asnjë marrëveshje ose angazhim, i cili kufizon aftësinë e bankës për ti zotëruar ato lirisht dhe në mënyrë të pavarur në rast nevoje, aktualisht dhe në të ardhmen. Aktivet likuide përfshihen mbi baza neto, duke përjashtuar interesat e përllogaritura dhe duke zbritur fondet rezervë. Ne perfshirjen e aktiveve likuide, qe i përkasin pikave 8,9,10, 14,dhe 15 ne tabelen e mesiperme, do te perdoren haircut-et e përcaktuara në rregulloren Nr 71 per "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit".

Në përllogaritjen e pasiveve afatshkurtra përfshihen të gjitha detyrimet me afat maturimi të mbetur deri në 1 (një) vit, përveç letrave me vlerë të Qeverisë Shqiptare të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes si dhe të depozitave nga të tretë të bllokuara si kolateral/garanci në bazë të një marrëveshjeje të caktuar me bankën. Në rastin e degës së bankës së huaj, në përllogaritjen e këtyre pasiveve afatshkurtra nuk përfshihen detyrimet ndaj bankës mëmë me afat të mbetur maturimi mbi 1 (një) muaj.

Banka monitoron strukturën e maturitetit të aktiveve dhe të detyrimeve me qëllim identifikimin e gap-eve të mundshme të maturitetit dhe per monitorimin e gap-eve, klasifikon fluksset hyrëse dhe dalëse nga aktivet (të drejtat), pasivet (detyrimet) dhe zërat jashtë bilancit, sipas intervaleve të maturimit. Si datë të arkëtimit të të drejtave perdoret data më e fundit të mundshme të arkëtimit, dhe si datë të shlyerjes së detyrimeve datën më të parë të mundshme të shlyerjes sipas intervaleve të mëposhtme . Struktura e maturitetit te aktiveve dhe pasive per daten 31 Mars 2026 paraqitet me siper.

13

DEPOZITA EKUIVALENTE E KAPITALIT DHE MATJA DHE KONTROLLI I KUFIJVE TË RREZIKUT

DEPOZITA EKUIVALENTE E KAPITALIT DHE MATJA DHE KONTROLLI I KUFIJVE TË RREZIKUT

Nr.	DEPOZITA EKUIVALENTE E KAPITALIT (DEK-A) : SHUMA	SHUMA
1	Depozitë në Bankën e Shqipërisë me normë interesi të përcaktuar me marrëveshje midis tyre.	
2	Bono thesari dhe obligacione të emetuara nga Këshilli I Ministrave i Republikës së Shqipërisë.	48,898,782.91
3	Letra me vlerë të emetuara nga Banka e Shqipërisë.	
	SHUMA	48,898,782.91

Kodi	MATJA DHE KONTROLLI I KUFIJVE TË RREZIKUT	SHUMA
1	Totali i aktiveve në fund të tremujorit paraardhës	209,370,166.73
2	Teprica e kredisë e tremujorit raportues	132,602,021.02
3	Raporti tepricë kredie / total i aktiveve (në %) (2:1 x100)	63.33%
4	Kufiri maksimal i rrezikut	70%

Në Bankën OTP Albania, politika e shpërblimeve është ndërtuar për të nxitur performancën, për të përforcuar kulturën e rezultateve dhe për të siguruar një sistem të drejtë dhe të motivues për të gjithë punonjësit. Qëllimi kryesor i kësaj skeme është arritja e objektivave të vendosura dhe rritja e cilësisë së shërbimeve dhe produkteve, duke kontribuar në suksesin e përgjithshëm të bankës.

Të gjithë punonjësit janë pjesë e një skeme shpërblimi të përcaktuar sipas pozicionit të tyre.

Çdo punonjës mund të përfshihet vetëm në një skemë shpërblimi në të njëjtën kohë.

Struktura e Shpërblimeve Politika e shpërblimeve përbëhet nga tre komponentë kryesorë:

1. *Paga Bazë (Fikse)*
2. *Paga Variable (Bonuse)*
3. *Përfitime të jera*

1. Paga Bazë (Fikse)

Paga bazë përfaqëson të ardhurat bruto përjashtuar përfitimet e tjera dhe bonuset.

a. Percaktimi i pagës bazë për punonjësit lidhet me elementët si më poshtë:

- *Përgjegjesitë e pozicionit dhe aftësitë profesionale që kërkohen për këtë pozicion;*
- *Ruajtje e një niveli page konkurues në treg;*
- *Eksperiecën e punonjësit në këtë pozicion;*
- *Strukturën e gradës për këtë pozicion;*

b. Nderkohë rritja e pagës bazë për punonjësit lidhet me plotësimin e kritereve si më poshtë :

- *Performanca e punonjësit;*
- *Niveli i pagës së punonjësit, krahasuar me nivelin e pagës sipas gradës;*
- *Buxheti vjetor i përcaktuar për rritjen e pagave;*
- *Promovimi i punonjësit në një pozicion me përgjegjësi më të madhe;*
- *Periudha që ka kaluar nga rritja e fundit e pagës.*

Pagat bazë për Bordin e Menaxhimit, përcaktohen sipas politikave të Grupit OTP Bank.

2. Paga Variabël (Bonuse)

Paga variabël është e lidhur ngushtë me performancën vjetore dhe rezultatet e arritura.

Ajo përfshin:

- *Bonuse tremujore për forcën shitëse, bazuar në rezultatet e shitjeve*
- *Bonuse vjetore për stafin mbështetës të Drejtorisë së Përgjithshme, në përputhje me performancën dhe buxhetin e miratuar*
- *Bonuse për drejtuesit ekzekutivë dhe pozicione të tjera kyçe, të përcaktuara sipas politikave të Grupit OTP Bank dhe të lidhura me objektiva specifikë dhe përqindje të paracaktuara*

Sipas politikës së shpërblimeve të Grupit OTP Bank, Drejtuesit Ekzekutivë dhe disa pozicione të tjera drejtuese përfitojnë bonus bazuar në: pozicionin e tyre, performancën dhe në një përqindje të përcaktuar për çdo pozicion. Pozicionet që përfshihen në këtë kategori, përcaktohen sipas kritereve të Grupit OTP Bank.

Këshilli Drejtues shpërblehet me një pagesë fikse mujore.

3. Përfitime të tjera

Përfitime të tjera mund të jenë në formë monetare ose jo monetare, si më poshtë:

- *Paketë ushqimore*
- *Shpërblim për leje lindjeje*
- *Kontroll mjekësor periodik*
- *Norma preferenciale për produktet e kredisë*
- *Paketa telefonie*
- *Aktivitete Team Building*
- *Ditë shtesë leje për vjetërsinë dhe ditën e lindjes*
- *Kontribut në Fondin Vullnetar të Pensionit Privat*
- *Dhurata për fëmijët*

KËSHILLI DREJTUES

Vlera totale e agreguar e pagesave dhe shpërblimeve për vitin aktual fiskal	E menjehershme per periudhen aktuale	Per periudha te kaluara ('000)
Elemente te pandryshueshem te shperblimit		
Cash/bonus	*3,789*	*3,901*
aksione		
te tjera		
Elemente te ndryshueshem te shperblimit		
Cash/bonus		
aksione		
te tjera		

DREJTUESIT EKZEKUTIVË

Vlera totale e agreguar e pagesave dhe shperblimeve per vitin aktual fiskal	E menjehershme per periudhen aktuale	Per periudha te kaluara ('000)
Elemente te pandryshueshem te shperblimit		
Cash/bonus	*128,954*	*144,497*
aksione		
te tjera		
Elemente te ndryshueshem te shperblimit		
Cash/bonus	*51,053*	*35,247*
aksione		
te tjera		